PANAIRI I EDUKIMIT

we challenging!



Edicioni i 14të
05 - 06 Maj 2022
Pallati i Rinisë
Prishtinë, Kosovë

Nën Patronatin e
Qeverisë së
Republikës së Kosovës

www.ceokos.com/
educationfair/

Përmbledhje e Panairit të Edukimit 2022
Edicioni i 14-të

Pas një ndërprerjeje dy vjeçare dhe shumë sfidave e vështirësive që janë shkaktuar si pasojë e pandemisë, me 5 dhe 6 Maj 2022 është mbajtur Edicioni i 14-të i Panairit të Edukimit i organizuar nga kompania CEO – Congress & Event Organization. Ky edicion është organizuar në bashkëpunim me Agjencinë e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur. Kjo agjenci ka mbështetur pjesëmarrjen e të gjitha qendrave të kompetencës Kosovë.

Ky panair tash e 14 vite, organizohet me qëllim të promovimit të punës së institucioneve edukativo-arsimore, ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësim-marrjes, informimin e nxënësve dhe studentëve të rinjë rreth programeve të ndryshme që ofrojnë institucionet arsimore në vend dhe jashtë, me qëllim që të ndihmohen rreth orientimit sa më të lehtë në karrierë.

Kjo ngjarje e vetme promovuese e edukimit dhe arsimit në Kosovë, është mbështetur edhe nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Edicioni e 14-të i Panairit të Edukimit, përfshiu pjesëmarrës në cilësinë e ekspozuesëve të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë dhe nga jashtë si: Gjimnazet, shkollat e mesme profesionale, qendrat e kompetencës, institucione të arsimit të lartë si kolegje e universitete të ndryshme, qendra trajnuese, kurse të gjuhëve të huaja etj.

Përpos institucioneve të arsimit nga të gjitha vendet e Kosovës, vlenë të përmendet edhe pjesëmarrja e institucioneve arsimore të huaja nga shtete si: Austria, Turqia, Shqipëria, Kanada etj.

Pjesëmarrja e institucioneve më kredibile edukativo-arsimore, ka ndikuar shumë në rritjen e interesimit dhe vizitës në numër të madh të panairit nga nxënësit, studentët, prindërit dhe faktorët e tjerë vendimmarrës.

Në ceremoninë e hapjes prezent ishin mysafirë nga institucionet qeveritare, komunat, ambasadorë dhe zyrtarë nga misionet e huaja diplomatike në Kosovë etj.

Hapja e panairit është bërë nga Kryetari i Komunës së Prishtinës, Z. Përparim Rama, i cili theksoi rëndësinë e mbajtjes së një panairi të tillë ku përgëzoi kompaninë organizatore për një organizim profesional dhe për kontributin e saj në shoqëri rreth ngritjes së vetëdijes dhe rritjes së cilësisë së arsimit në Kosovë.

Pas kryetarit të komunës, fjalën pati Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Znj. Arbërie Nagavci ku shprehi mirënjohjen e saj për kompaninë organizatore që i ka dhënë fokus të veçantë qendrave të arsimit profesional, ngaqë është një nga fushat më të rëndësishme dhe prioritet i ministrisë që ajo udhëheqë dhe qeverisë në tërësi. Njëkohësisht theksoi se është shumë e rëndësishme çdo ndihmë që ofrohet rreth orientimit të nxënësve dhe studentëve në karrierë, aq më tepër organizimi i një panairi që e vë këtë gjë në qendër të vëmendjes.

Për më tepër, ministrja theksoi përkrahjen që i është dhënë kësaj ngjarjeje si këtë vit po ashtu edhe vitet e kaluara dhe inkurajoj nxënësit dhe studentët që të vizitojnë këtë panair në mënyrë që të marrin informata të dobishme për orientimin e tyre profesional në të ardhmen.

Panairi i Edukimit në numra – Statistika nga Edicioni i 14-të

Informata mbi ekspozuesit dhe vizitorët:

Numri i ekspozuesve vendor: **109**

Numri i ekspozuesve të huaj: **11**

Numri total i ekspozuesve: **120**

Origjina e ekspozuesve: **Kosovë, Shqipëri, Austri, Turqi dhe Kanada**

Numri i vizitorëve: **7340**

Panairi i Edukimit në Media

Edicioni i 14-të i Panairit të Edukimit, ka tërhequr vëmendje të madhe edhe të mediave për shkak të ekspozuesve dhe numrit të madh të vizitorëve, të cilat kanë mbuluar pjesën e para fillimit të panairit, hapjen dhe mbarëvajtjen e panairit si dhe përfundimin.

Ngjarja është përcjellur nga televizioni kombëtar dhe nga mediumet më të mëdha private si TV, Radio, Media Elektronike si portale dhe agjenci të lajmeve.

Përshtypjet

Znj. Arbërie Nagavci – Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit: Inkurajoj të gjithë nxënësit dhe studentët të vizitojnë këtë panair që ministria jonë e ka përkrahur edhe në të kaluarën dhe përgëzoj organizatorët për punën e tyre që po sjellë rezultate konkrete duke i ndihmuar nxënësit dhe studentët të orientohen në karrierë.

Z. Chris Gas - Georgian College Canada - Kemi vërejtur se ka shumë interesim për studime në Kanada, për atë arsye kemi vendosur që të marrim pjesë në panair dhe të zbulojmë një treg të ri, duke pasur parasysh se veçse jemi duke hulumtuar tregun në Ballkan, menduam se ardhja jonë këtu do të ishte me interes

Z. Eduardo Fernandez Aguilera - Modul University Vienna: Nuk kemi qenë asnjëherë më herët në Prishtinë kështu që kemi vendosur të vijmë sepse është panairi më i rëndësishëm i edukimit në Kosovë dhe kemi shumë kandidatë nga këtu kështu që është mundësi shumë e mirë për neve që ti informojmë ata rreth programit tonë.

AAB College Representative: Sikurse në vitet e kaluara, Kolegji AAB merr pjesë në Panairin e Edukimit edhe këtë vit. Qëllimi jonë kryesor është të informojmë vizitorët rreth programit dhe trajnimeve që instituti AAB ofron.

Z. Klinton Gashi: Qendra për Studime Universitare (QSU) FSK – E kemi parë Panairin e Edukimit si mundësi shumë të mirë për të promovuar Qendrën për Studime Universitare. Pasi që ka edhe pak kohë para se të hapet konkursi për rekrutim, presim që të kemi më shumë aplikime pas këtij panairi që po vizitohet në masë të madhe.

Pamje nga Panairi i Edukimit, Edicioni i 14-të 2022

Shihemi në Edicionin e 15-të të Panairit të Edukimit me 27-28 Prill 2023.